

INFORMACION MBI PROJEKTIN

SIGURIA PËR QËNIET NJERËZORE DHE KUFINJTË –
LUFTA KUNDËR TRAFIKIMIT TË EMIGRANTËVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR



Ky projekt është
financuar nga BE

Partneri kryesor:	Grupi 484
Partnerët zbatues:	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH); Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut (BCHR), Aleanca Qytetare nga Mali i Zi (GAMN); Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP/K); Shoqata e Avokatëve të Rinj Maqedonas (MYLA), Vaša prava Bosnje dhe Hercegovinë (VP BiH) dhe Këshilli Danez për Refugjatët (DRC). ¹
Bashkëpunëtorët:	Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Serbisë, Qendra Kombëtare e Pritjes për Azilkerkuesit në Shqipëri, Ministria e Brendshme e Malit të Zi, MARRI RC (Migrimi, Azili, Qendra Rajonale e Iniciativës Rajonale të Refugjatëve) nga Republika e Maqedonisë së Veriut, Ministria e Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Çështjeve të Sigurisë së Bosnjës dhe Hercegovinës, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracionin i Ministrisë së Punëve të Brendshme në Kosovë*.

INFORMACIONET KRYESORE TË PROJEKTIT

Ballkani Perëndimor (BP) vazhdon të jetë një rrugë tranziti për emigrantët e paligjshëm që përpiqen të hyjnë në Evropën Perëndimore nga Turqia. Emigrantët i kalojnë kufinjtë në mënyrë të paligjshme, kryesisht duke përdorur metoda dhe rrugë alternative, si dhe duke u ndihmuar nga individë dhe grupe të organizuara kriminale. Emigrantët e trafikuar preken nga forma të ndryshme të krimit, sidomos grupet më vulnerabël (gratë, fëmijët, të miturit e pashoqëruar), siç janë: dhuna, përdhunimet, vjedhjet, rrëmbimet, zhvatja e të hollave dhe trafikimi i qënieve njerëzore. Edhe pse vdekjet përgjatë udhëtimit drejt BP janë relativisht të rralla, ato ndodhin.

Trafikimi i emigrantëve është vazhdimisht ndër temat kryesore në Progres Raportet e BE-së për vendet e BP. Duke pasur parasysh se është një fenomen ndërkuftar, shtetet e BP kanë nevojë për një reagim të përbashkët ndaj këtij problemi dhe një nga objektivat kryesore duhet të jetë krijimi i bashkëpunimit rajonal dhe fqinjësisë së mirë në BP përmes hartimit të një politike të unifikuar rajonale për trafikimin e emigrantëve.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE TË PROJEKTIT

Projekti u mendua si një reagim rajonal i 7 OSHC-ve në Këshillin Ballkanik të Refugjatëve dhe Migracionit (BRMC) dhe DRC ndaj problemit serioz të përbashkët, trafikimit të emigrantëve në Ballkanin Perëndimor. Në këtë nisëm do të angazhohen 90 OSHC, duke kontribuar në përmirësimin e praktikave të mbrojtjes së emigrantëve, e kuadrit ligjor dhe politikave në këtë fushë, në Ballkanin Perëndimor. OSHC-të do të ndihmohen për t'u fuqizuar, me qëllim zbatimin dhe zhvillimin e projekteve kombëtare që synojnë parandalimin e trafikimit të emigrantëve dhe që ofrojnë shërbime për këto emigrantë të trafikuar. Njëkohësisht OSHC-të do të zhvillojnë bashkëpunime me organet shtetërore, median dhe botën akademike. Kjo nisëm e bazuar në partneritete shumëplanëshe, do të kontribojë për të patur një menaxhim më të mirë të mbrojtjes së emigrantëve të trafikuar.

¹ Grupi 484, Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut (BCHR), Programi i të Drejtave Civile Kosovë (CRP / K); Shoqata e Avokatëve të Rinj Maqedonas (MYLA), Vaša prava Bosnje dhe Hercegovina (VP BiH) janë anëtarët e rrjetit “Këshilli Ballkanik i Migracionit për Refugjatë” (BRMC).

INFORMACION MBI PROJEKTIN

SIGURI PËR NJERËZIT DHE KUFINJTË –
LUFTA KUNDËR TRAFIKIMIT TË EMIGRANTËVE NË BALLKANIN PËRËNDIMOR



Ky projekt është
financuar nga BE

Aktivitetet do të ndahen në katër grupe duke svnuar që të përmbushen të gjitha objektivat e kësaj nisme:



Siguria dhe mbrojtja
e kufirit



Mbrojtja e të drejtave dhe
lirive të migrantëve



Kontributi në
Përafrimin me politikat e BE-së

1. Aktivitetet përgatitore.

2. **Aktivitetet për rritjen e kapaciteteve** të organizatave që veprojnë në nivel kombëtar dhe lokal, po ashtu edhe institucioneve që kanë rol kryesor në luftën kundër trafikimit të emigrantëve në vendet e BP.

3. **Financimi dhe mbështetja** e 24 projekteve kombëtare dhe 6 rajonale, si dhe organizimi i disa konferencave rajonale me qëllim prezantimin e gjetjeve kombëtare dhe rajonale ndaj çështjeve të trafikimit të emigrantëve.

4. **Aktivitetet e avokimit** për harmonizimin e praktikës, kuadrit ligjor dhe politikave në rajonin e BP (materiale për avokim, 6 tryeza kombëtare dhe 2 konferenca rajonale).

GRUPET E SYNUARA

Grupet kryesore të synuara janë 90 OSHC që punojnë në fushën e emigracionit, sigurisë, të drejtave të njeriut, të drejtave të grave, të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve. Përfituesit e fundit do të jenë: emigrantët, duke përfshirë edhe ato të trafikuar, përfaqësuesit nga institucionet shtetërore, akademikët, media dhe qytetarët e vendeve të BP.